



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-22-0549**

**Në ankesën e**

***Paditësi***

**R H**, Podujevë, i Përfaqësuar nga avokati **B I**, Prishtinë.

**Kundër**

***E paditura/Ankuesja***

**NSH.FAN "Zahir Pajaziti"**, e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5994 të datës 09 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 tetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-5994 të datës 09 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 28 gusht 2014, paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0298 të datës 04 gusht 2014, me të cilin Autoriteti i Likuidimit, e kishte refuzuar kërkesën e tij për 3 paga të pa paguara për periudhën janar deri mars 2006 në shumë prej 867,52, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi pohon se ai dhe punëtorët e tjerë të ndërmarrjes ishin pre e ndërprerjes masive të marrëdhënies së punës nga ndërmarrja andaj ai ka të drejtë në 3 pagat e fundit të pa paguara, bazuar në nenin 40.1.6.1 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së. Bashkë me ankesë paditësi ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0298 të datës 04 gusht 2014.

Me datë 08 qershor 2022, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AKP-së. AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja ka pohuar se paditësi ka dështuar të tregoi se cila dispozitë ligjore është shkelur me Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se kërkesa për kompensim të pagave nga muaji janar deri mars 2006 është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi ka dështuar të paraqet prova në gjykatë se ai i ka kërkuar këto paga brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente. AKP-ja pohon se afati i fundit më i vonshëm i parashkrimit të kërkesës ishte muaji mars 2009. Prandaj nga këto arsye me të drejtë Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e këtyre pagave.

Me datë 15 korrik 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-së një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi pohon se kërkesa e tij për 3 paga nuk është parashkruar siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit, pasi që ai e ka pranuar Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, dhe ky njoftim e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Me këtë parashtresë ai kërkon edhe

shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit. Bashkë me këtë parashtresë ai dorëzon Autorizimin e Avokatit, Njoftimin e AKM-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, dhe një kopje të Listës së pagave të papaguara të muajit janar deri në mars 2006 e nënshkruar nga menagjmenti i NSH-së, si dhe autorizimin e avokatit, si dhe Regjistrin e pranimet të Njoftime për ndërprerje të marrëdhënies së punës të punëtorëve të NSH-së.

Me datë 09 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-5994, e aprovoi ankesën e paditësit si bazuar, e shfuqizoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0298 të datës 23 qershor 2014, si dhe e obligoi AKP-në ti paguaj paditësit 3 pagat e fundit të papaguara në shumë prej 867,51 euro, sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi ishte një punëtor i NSH Fan "Zahir Pajaziti" në Podujevë i cili ka pretenduar se ka qenë punëtor i saj deri në momentin e privatizimit me 24 mars 2006. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar se me njoftimin e AKM-së të datës 24 mars 2006, dërguar paditësit ai është udhëzuar që çdo kërkesë kreditore që mund ta ketë ndaj NSH-së ta paraqet në procedurën e likuidimit, kur do të fillojnë këto procedura. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se e paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar nga ankuesi. Ankuesi kërkesën e ka mbështet, në Njoftimin e AKM-së të datës 24 mars 2006, dhe në Listën e pagave për periudhën janar-mars 2006 e lëshuar nga shërbimi financiar i ndërmarrjes. Lartësia e kompensimit është caktuar bazuar në Listën e pagave për periudhën janar-mars 2006 e lëshuar nga shërbimi financiar i ndërmarrjes, e nënshkruar nga drejtori i NSH-së, drejtori financiar dhe kryetari i sindikatës. Andaj nga këto arsye, shkalla e I-rë e DHPGJS-së konstaton se paditësi i ka përmbushur kushtet ligjore nga neni 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së që ti njihet e drejta në pagesën e tri pagave të fundit të papaguara që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Me datë 25 shtator 2022, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-5994 të datës 09 shtator 2022, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës

materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0298 i datës 04 gusht 2014. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar- afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet deri në mars 2009, ndërsa kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me 26 shtator 2013, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 31 tetor 2022, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së dhe ka pohuar se AKP-ja në ankesën e saj vetëm i ka përsëritur pohimet dhe argumentet e dhëna e nuk ka paraqitur asnjë provë të re ose as një argument të ri ligjor. Tutje paditësi pretendon se Gjykata e Shkallës së I-rë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike pas administrimit të provave të sjellura nga paditësi, andaj me të drejtë Gjykata ka konstatuar se ankesa është bazuar. Nga këto arsye paditësi ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të

Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së e ka refuzuar si të pa vlefshme, kërkesën e paditësit për kompensimin e 3 pagave të fundit të paguara nga muaji janar e deri në muajin mars 2006, në shumë prej 867,52 euro, me arsyetimin se kërkesa e paditësit për këto 3 paga, është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit ka vërejtur që Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ka aprovuar ankesën e paditësit si bazuar dhe e ndryshoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0298 të datës 04 gusht 2014, si dhe e obligoi AKP-në të paguaj paditësit 3 pagat e fundit të papaguara në shumë prej 867,51, si dhe shpenzimet e përfaqësimit prej 208 euro të cilat do të paguheshin sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së I-rë, nuk mund të pajtohet me konstatimin e gabuar të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për këto 3 paga është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ai ka sjellë Njoftimin zyrtar të ish AKM-së me të cilën vërtetohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 24 mars 2006. Ky njoftim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Në bazë të këtij njoftimi, atë ditë është shitur Ndërmarrja në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës ankuesit i është ndërprerë menjëherë. Në këtë njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësinë e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të

shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”.

Paditësi duke u bazuar në këtë njoftim ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me datë 26 shtator 2013. Andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi po ashtu ka sjellë me ankesë, edhe një kopje te listës së pagave të pa paguara për periudhën janar e deri në mars 2006, e cila listë është nënshkuar nga menagjmenti i NSH-së dhe është vulosur me vulën e NSH-së. Në bazë të kësaj liste shihet se NSH-ja i ka mbetur borxh për pagat e muajit janar-mars 2006, në shumën e përgjithshme 867,52 euro, të pagës bruto.

Prandaj duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se paditësi ka të drejtë ti paguhet kompensimi për 3 pagat e fundit të pa paguara në periudhën e cekur ne shume prej 867,52 euro, në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Borxhi kryesor në shumë prej 867,52 euro lidhur me 3 pagat e fundit të pa paguara, do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë taksën gjyqësore për procedurën ankimore e ka paguar me datë 14 qershor 2022 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 05 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_

**URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:**

Ju lutem dërgojeni këtë Aktgjykim tek:

- Palët,
- Shkallës së I-rë të DHPGJS, në lëndën C-IV-14-5994.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_